KRONIKË E ZEZË

Tre të vrarë në Lipjan

28 korrik 2023, 18:13

Shpërndaje në

Tre persona janë vrarë me armë zjarri në fshatin Rufc të Lipjanit të premten pasdite, ka mësuar KOHA. Sipas burimeve, tre të vrarët janë anëtarë të së njëjtës familjeje. Dyshohet që kryefamiljari ka vrarë bashkëshorten dhe djalin, e më pas ka qëlluar edhe veten.

E njëjta informatë është konfirmuar disa orë më pas edhe nga Prokuroria Themelore në Prishtinë. "Sipas informatave nga vendi i ngjarjes, dyshimet çojnë drejt vrasjes së dy viktimave nga arma e zjarrit, si dhe një vetëvrasjeje (brenda familjes)", ka njoftuar Prokuroria.

Policia ka konfirmuar se në vend të ngjarjes ka gjetur tre trupat e pajetë.

Sipas njoftimit të Policisë, autoritetet menjëherë kanë nisur hetimet për rastin.

"Rreth orës 16:30 policia ka pranuar informatën për tre persona të pajetë në fshatin Rufc të Lipjanit. Menjëherë pas marrjes së informatës policia ka dalë në vendin e ngjarjes ku janë hasur tre trupa të pajetë. Vdekja e të cilëve është konstatuar nga ana e ekipit mjekësor. Aktualisht policia ka nisur një hetim për rastin dhe rrethanat që karakterizojnë ngjarjen", thuhet në njoftim të Policisë.

Trupat e viktimave janë dërguar për obduksion.

Për ngjarjen e rëndë, ngushëllime ka shprehur kryeministri Albin Kurti. Ai ka thënë se "tronditje të thella lënë boshllëk në zemrat e secilit prej nesh".

Kërkohet paraburgimi i qytetarit që e kanosi deputeten e PDK-së në Facebook

23 vjet burgim pesë personave që e detyruan një vajzë të kryente marrëdhënie seksuale për para

11 armë pa leje sekuestroi Policia të premten, shumicën në Prishtinë

20-vjeçarit që gjuajti me armë te koncerti i Mozzikut, i gjenden disa armë të tjera në shtëpi

Plagoset një djalë në Prishtinë

Vrasja në Lipjan: Policia gjeti dy revole në shtëpi

Tentim vrasje në Pejë, Policia e ndjek pas të dyshuarin

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#VRASJE

Taboola Feed

Një produkt i harruar që mund të pastrojë enët e gjakut.
Si të pastroni enët e gjakut dhe të ulni kolesterolin
Kryekardiologu i Shqipërisë | Sponsored
Lexo më shumë

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Kosova e ka të domosdoshme fitoren ndaj Zvicrës
Basketbollistët e Kosovës nuk kanë opsion tjetër veçse ta mposhtin Zvicrën për herën e dytë brenda dhjetë ditësh, në kuadër të rundit të tretë parakualifikues për "Eurobasket 2025". …
Kohanet



Nëse vuani nga presioni i lartë i gjakut, lexoni këtë tani!
Provojeni këtë para se të shkoni në shtrat: venat mund të pastrohen
Kryekardiologu i Shqipërisë | Sponsored
Lexo më shumë

TË TJERA

Aktakuzë ndaj një serbi për krime lufte në Kosovë

Gjuajtje me armë e hedhje të granatës, ndërpritet koncerti i Mozzikut në Gjilan

Një 28-vjeçar gjendet i vdekur brenda veturës në Prishtinë

Porositi vrasës me pagesë për ta ekzekutuar bashkëshortin shqiptar, arrestohet gruaja në Itali

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispositave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeljet e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!